



The
Federal Government

Kthimi vullnetar dhe riintegrimi i qëndrueshëm në Kosovë

Qeveria Federale e Gjermanisë mbështet
kosovaret dhe kosovarët gjatë kthimit
në Kosovë.





Informacion dhe këshillim në Gjermani

Ku mund të marr informacionet e para?

 **Me telefon:** Për pyetjet fillestare mund t'ju ndihmojë linja direkte e Entit për Emigracion dhe Refugjatë (BAMF): +49 911-9430.

 **Online:** Në www.ReturningfromGermany.de/de/countries/kosovo ka informacione lidhur me programet e kthimit dhe riintegrit, të dhëna të kontaktit të qendrave të këshillimit, si informacionet të landeve në lidhje me Kosovën. Në kuadër të një këshillimi virtual, ju mund të merrni kontakt me një këshillues të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Kosovë. Në këtë mënyrë ju mund të informoheni nëpërmjet një bisede të drejtpërdrejtë në gjuhën tuaj amtare lidhur me gjendjen në vend. Faqet disponohen në gjuhën shqipe, gjermane, angleze dhe serbe.

Në www.startfinder.de/kosovo gjeni informacione lidhur me këshillimin, mbështetjen dhe oferta në Gjermani dhe në Kosovë.

 **Personalisht:** Një këshillim personal e merrni në një zyrë këshillimore për kthimin, që gjenden në të gjithë Gjermaninë.

Në rast nevoje, një zyrë këshillimore për kthimin me të drejtë për të bërë kërkesë, afër jush, mund të bëjë një kërkesë individuale pranë Zyrës qendrore për Dhënie të informacionit për Mbështetje të Kthimit (ZIRF), për të marrë informacione konkrete, specifike për rastin lidhur me kthimin tuaj në Kosovë.

Një zyrë këshillimore për kthimin afër jush e gjeni në portalin e informacionit për kthimin me vullnet të lirë dhe riintegrimin www.ReturningfromGermany.de/de/centres

Të gjitha ofertat e këshillimit janë falas dhe pa detyrim.



Mbështetja gjatë kthimit vullnetar

Çfarë forme mbështetje mund të marr unë?

Programi federal-lande REAG/GARP (Reintegration and Emigration Programme for Asylum Seekers in Germany/ Government Assisted Repatriation Programme) ju mbështet financiarisht dhe nga ana organizative gjatë kthimit me vullnet të lirë në Kosovë.

Ju mund të kërkonti mbështetjen e mëposhtme për kthimin pranë IOM-së (REAG/GARP):

- Mbështetje në organizimin e udhëtimit
- Marrjen përsipër të shpenzimeve të udhëtimit
- Pagesën e një ndihme të reduktuar udhëtimi
- Mbështetje të veçantë për grupe vulnerabël, p.sh. furnizim të përkohshëm me barna

Nëse dëshironi të bëni një kërkesë për mbështetje, ju lutemi kontaktoni një zyrë këshillimore për kthimin afër jush:

www.ReturningfromGermany.de/de/centres



**PARA UDHËTIMIT
TË KTHIMIT**

Informacion dhe
këshillim



**GJATË UDHËTIMIT
TË KTHIMIT**

Mbështetje
organizative dhe
financiare



**PAS UDHËTIMIT
TË KTHIMIT**

Oferta
riintegrimi



Mbështetje riintegrimi në Kosovë

Kujt mund t'i drejtohem kur jam sërish në Kosovë?

Projekti URA i financiar nga qeveria federale dhe landet federale mbështet riintegrimin e të kthyerve nga Gjermania në Kosovë.

Për këtë URA ofron në këshillim dhe përkujdesje individuale, që mund të përmbajë shërbimet e mëposhtme të mbështetjes:

- Mbështetje në mbërritjen në aeroport
- Ndihma të menjëhershme (p.sh. këshillim social, përkujdesje psikologjike, marrje përsipër të shpenzimeve mjekësore dhe të trajtimit mjekësor, qira dhe mobilim)
- Masa afatgjata riintegrimi (p.sh. këshillë për karrierën, ndërmjetësim pune, ndihmë fillestare për biznese fillestare, përkujdesje fëmijësh)
- Masa të veçanta për fëmijët (Pajisje bazë për fëmijët që shkojnë në shkollë, ndihmë mësimore pas mësimit, kurse gjuhe dhe aktivitete të kohës së lirë për fëmijë)

URA është e hapur për të gjithë personat që kthehen dhe ofron ndihma falas. Një mbështetje financiare është e rezervuar për të kthyerit nga landet federale pjesëmarrës të projektit Baden-Württemberg, Berlin, Bremen, Niedersachsen, Nordrhein-Westfalen, Sachsen, Sachsen-Anhalt, Schleswig-Holstein und Thüringen.

Qendra Gjermane e Informacionit për Migracionin, Aftësim profesional dhe Karriere (DIMAK) ofron ndër të tjera:

- Këshillim individual
- Mundësi punësimi dhe trajnimi në Kosovë
- Ndërmjetësim në programe mbështetje dhe trajnime në fushën e riintegritit social dhe profesional
- Ndhmë gjatë themelimit të kompanisë dhe udhëheqje profesionale
- Trajnime për të aplikuar për punë dhe mbështetje gjatë kërkimit për një vend pune
- Këshillim psikosocial

Pavarësisht nëse jeni ende në Gjermani ose në Kosovë: Çdo njeri mund të marrë një takim për të biseduar me këshillues të DIMAK-së. Këshillimi është falas, pa detyrim dhe konfidencial.

AWO Nürnberg ju ofron mbështetjen e mëposhtme për riintegrimin tuaj:

- Këshillim social-pedagogjik dhe psikologjik
- Këshillim juridik dhe mbështetje tek autoritetet zyrtare
- Marrje përsipër të shpenzimeve për ilaçe
- Materiale shkollore, kurse gjuhe dhe oferta për fëmijë dhe të rinj
- Këshillim me vizitë në shtëpi/mobile dhe përkujdesje
- Ndhma financiare (p.sh. kosto rinovimi, dru zjarri, artikuj ushqimorë dhe higjienë)

Mbështetjen e mëposhtme mund të kërkon pranë “Diakonie Kosova”:

- Marrja në aeroport
- Trajnime në profesione artizanale dhe ndërmjetësim të punës
- Përgatitje për punë të pavarur dhe mbështetje me veglat e punës
- Mbështetje financiare, ndihmë fillestare me artikuj ushqimorë, mbështetje tek autoritetet zyrtare, etj.
- Këshillim psikosocial
- Në raste të veçanta, rinovim të shtëpisë

Shënim ligjor

Botuesi:

Ministria Federale për Bashkëpunim
Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)
Referat 224 Rückkehr / Reintegration
BMZ Bonn
Dahlmannstraße 4
53113 Bonn
Tel.: +49 (0) 228 99 535-0
Faks: +49 (0) 228 99 535-3500
poststelle@bmz.bund.de
www.bmz.de

Redaktimi:

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Programi për Migracion dhe Zhvillim
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn

Stadi:

Korrik 2020

Fotografia:

f. 1: iStock; f. 4: URA Kosovo; f. 7: DIMAK Kosovo

Me porosinë e:



Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development



Federal Ministry
of the Interior, Building
and Community



Federal Office
for Migration
and Refugees



Zbatuar nga:



Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Formimi profesional i avancuar në Gjermani

Çfarë trajnimesh mund të bëj para kthimit?

Partnerë të ndryshëm të Qeverisë Federale të Gjermanisë dhe të landeve federale ofrojnë trajnime dhe formime profesionale të avancuara që ju ndihmojnë gjatë riintegrit në Kosovë.

Për shembull:

- Dhënien e njohurive për sektorin e hotelerisë
- Këshillim individual për krijimin e bizneseve fillestare
- Mbështetje gjatë kërkimit për një vend pune në Kosovë

➔ Nëse interesoheni për një nga masat, ju lutemi kontaktoni një zyrë këshillimore për kthimin afër jush
www.ReturningfromGermany.de/de/centres



Të gjitha kontaktet me një vështrim

Na kontaktoni:

Rückkehrzentrum “URA – die Brücke”

✉ ura.kosovo@bamf.bund.de

💻 www.ReturningfromGermany.de/de/programmes/ura

💻 www.bamf.de/ura

Deutsches Informationszentrum für Migration, Ausbildung und Karriere (DIMAK)

✉ dimak-kosovo@giz.de

👍 facebook.com/DIMAKKosovo

💻 www.startfinder.de/beratung-kosovo

Diakonie Kosova

☎ +383 (0) 28 515 141

☎ +383 (0) 44 587 297

✉ zyra.kthimi@diakoniekosova.org

💻 www.diakoniekosova.org

AWO Nürnberg

💻 www.awo-nuernberg.de/migration-und-integration/kosovoprojekt/angebote-im-kosovo/

Virtual Counselling

📞 WhatsApp: +383 (0) 49 968 523

Informacione të mëtejshme lidhur me ofertat për kthimin me vullnet të lirë dhe riintegrimin i gjeni në

💻 www.ReturningfromGermany.de/de/countries/kosovo

💻 www.startfinder.de/kosovo

Në bashkëpunim me:



Kreisverband
Nürnberg e.V.